

**AKT THEMILIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË "DIGITAL-TECH ALBANIA" SHPK**

**1 – EMRI DHE FORMA LIGJORE E SHOQËRISË**

Emri i Shoqërisë do të jetë "**Digital-TECH Albania Shpk**", nga këtu e më poshtë referuar si "shoqëria". Shoqëria është e organizuar si shoqëri tregtare e formës shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK).

**2- ORTAKËT E SHOQËRISË**

Shoqëria është themeluar nga ortakët:

**Znj Maria XEGA**, Shtetase Shqiptare, lindur ne Korce, me date 15.04.1988 me nr Pasaporte I85415121D

**Z. Enjan Gazhga**, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 30.11.1981, me kartë identiteti me Nr. Personal I11130028M.

**3- SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Rruga Themistokli Germenji, Nr 1, Tirane**  
Shoqëria mund të shtrijë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të themelojë degë, ose zyra përfaqsimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë etj.

Selia e Shoqërisë mund të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një vendim të Asamblesës së ortakëve të shoqërisë.

**4- OBJEKTI I SHOQËRISË.**

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që nuk ndalohet nga ligji në fuqi, të tillë si, por pa u kufizuar në:

- **Sherbime konsulence dhe trajnime profesionale në fushën e teknologjise se informacionit dhe telekomunikacionit, Softëare dhe hardëare.**
- **Këshillim, studim, trajnim ne fushen e teknologjise dixhitale.**

- ***Veprimtari ne fushen e teknologjise se informacionit, analize, projektim, programim, testim dhe trajnim programesh aplikative, manaxhim projektesh.***
- ***Këshillim të klienteve të firmës për manaxhim marketingu, biznesi global apo projektesh te ndryshme.***
- ***Konsulence Globale Financiare, Manaxhim te riskut global.***
- ***Sherbime te keshillimit Financiar dhe pajtuesmerise globale te Prokurimit.***
- ***Si edhe çdo veprimtari tjetër tregtare, e lejueshme nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.***

## **5-PERIUDHA E AKTIVITETIT**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Cdo ndryshim në lidhje me periudhën e aktivitetit mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

## **6 –KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 100 (njëqind) lekë**.

Kapitali themeltar ndahet në **2 (dy) pjesë/kuotë** simë poshtë:

- Ortaku **Znj.MARIA XEGA**, zoteron 50% te kapitalit Themeltar me vlerë nominale 50 (pesëdhjetete leke).
- Ortaku, **Z. ENJAN GAZHGA**, zotëron 50% të kapitalit themeltar, me vlerë nominale 50 (pesëdhjete) lekë .

## **7- ORGANET VENDIMARRËSE TE SHOQËRISË**

Organet vendimarrëse të shoqërisë janë:

- a - Asambleja e Përgjithshme
- b - Administratori i Shoqërisë

## **8- ADMINISTRATORI**



**Administratori i parë Shoqërisë është:**

**Znj.MARIA XEGA**, shtetase shqiptare, lindur në Korçë, më 15.04.1988 e identifikuar me pasaportë NR I85415121D me zotësi të plotë juridike për te vepruar.  
Administratori i Shoqërisë Znj.Maria XEGA caktohet për një afat 2(dy)vjecar.

Mënyra e emërimit, e shkarkimit,të drejtat dhe detyrimet e administratorit si dhe koha e qëndrimit në detyrë të tij percaktohet ne Statut dhe ne ligj.

**9. MBYLLJA (LIKUJDIMI I SHOQËRISË)**


Në rast të falimentimit të shoqërise, procesi i likujdimit do të realizohet në perputhje me procedurat ligjore në fuqi në momentin e falimentimit.

**ORTAKET E SHOQËRISË**

**Znj. MARIA XEGA**



**Z. ENJAN GAZHGA**



**Datë** 07 / 02 / 2023